

E ENJTE DATA 16 SHKURT 2023

FJALA E DEPUTETIT LUÇIANO BOÇI

Të nderuar deputetë,

Pamjet e shëmtuara të bllokimit të parlamentit nga forcat e Gardës, për të mos lejuar deputetët të hyjnë në sallë, përsëriten e përsëriten, në këtë ushtrim force ushtarake ndaj deputetëve të zgjedhur, të cilët nuk përfaqësojnë mandatet e tyre personale, por mandatet e zgjedhësve. Deputetët e përjashtuar nga ju, në mënyrë të padrejtë, në formën e dënimit politik, në përputhje me Rregulloren kërkuar sot që të ishin prezent në mbledhjen e Byrosë. Ata kanë kërkuar që të zhvillohet kjo mbledhje. Ju, zonja Kryetare, keni urdhëruar Gardën, që të mos futen në mbledhjen e Byrosë. Kjo është një shkelje e rëndë e të drejtave të deputetit. Neni 65 e përcakton qartë në pikat e tij se deputeti që ankimon vendimin e marrë kundrejt tij, duhet të jetë prezent në mbledhje ose duhet të jetë përfaqësuesi i tij ligjor. Si mundet, ju, zonja Kryetare, që flisni dhe përjashtoni deputetët në emër të Rregullores, të shkelni Rregulloren dhe të vini këtu sikur s'ka ndodhur asnjë gjë, me atë qetësinë olimpikë të të korruptuarit nga Kryeministri, të Kryeministrit tradhtar, siç e kemi cilësuar ne?! Kjo është e vërteta, sepse urdhrat nga ai i merrni.

Gjithashtu, po t'i kthehemi procedurës së kërkesave tona, që prej javës së kaluar kemi kërkuar seancë pyetjesh urgjente dhe siç është e përcaktuar në nenet e Rregullores, Kryeministri duhet të ishte prezent menjëherë në seancë. Kemi dy javë që e kërkojmë. Kemi kërkuar dy komisione hetimore, zonja drejtuese e seancës. Komisionet hetimore janë firmosur, i pari, për çarterat nga 35 deputetë dhe i dyti, për çështjen "Rama – McGonigal" nga 44 deputetë. Këtë të drejtë e përcakton Kushtetuta në nenin 77, pika 2. Është kjo Kushtetutë që të mban ty aty, që e mban Shqipërinë këtu të korruptuar, që na mban neve këtu. Pse e shkel me këmbë Kushtetutën ti? Dhe më tregon mua Rregulloren, dhe më përjashton! A do të ta lexoj? Neni 77, pika 1 dhe pika 2 thonë: "Kuvendi zgjedh nga gjiri i tij komisione të përhershme, si dhe mund të caktojë komisione të posaçme. Kuvendi ka të drejtë që me kërkesën e një së katërtës së të gjithë deputetëve të tij është i detyruar të caktojë komision hetimor". Pse e shkelni Kushtetutën? Zonja drejtuese e seancës, pse e shkelni nenin 25 të Rregullores, i cili në mbështetje të Kushtetutës e cilëson fare saktë se kur një e katërta e deputetëve kërkon ngritjen e komisionit hetimor, komisioni ngrihet menjëherë. Kush është ky që del në studio televizive dhe thotë: "Unë nuk ngre komisione hetimore". Jeni apo nuk jeni ju, drejtuesja e Kuvendit? Ne e dimë se kush është de facto, por të paktën de jure, ushtro autoritetin tënd! Ne e kemi kërkuar komisionin hetimor për një çështje madhore, që është shqetësimi kryesor i shqiptarëve, për thikën në zemër që i keni ngulur marrëdhënive me SHBA-në. Për dy vjet, ju ishit pro-amerikanët. I harruat ato rublat që na përmendnit? Çdonjëri prej jush ishte i orientuar nga rublat.